



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni Parlamentar për Integrimin European

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.
64/2012, DATË 31.05.2012 “PËR PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR”

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 28.01.2019, me cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 64/2012, datë 31.05.2012 “Për Peshkimin”, të ndryshuar*”.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij është mundësimi i rregullimit të peshkimit bregdetar artizanal në kuadër të bashkëmenaxhimit me organizatat e peshkimit, për një qasje më të afërt me fusha të rëndësishme të politikës së përbashkët të peshkimit të Bashkimit Evropian, dokumentit programatik të Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit. Projektligji synon të japë përcaktimin e saktë të organizatave të peshkimit, funksionin dhe objektivat e tyre si dhe format apo mënyrat dhe kriteret e ndryshme të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit.

Objektiv i rëndësishëm i këtij projektligji është përcaktimi i parimeve mbi të cilat mbështetet dhe kushteve që duhet të plotësojnë organizatat e peshkimit për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së peshkimit të transferuar për menaxhim prej tyre. Në projektligj riformulohen më qartë disa përkufizime si dhe përcaktohen detyrat e institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës.”.

..

Plani Kombëtar për Integrimin European

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 64/2012, datë 31.05.2012 “Për Peshkimin”, të ndryshuar” është i parashikuar ne Kapitullin 13: Peshkimi”

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njihet rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Europian;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit Europian;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE): *Titulli III “Bujqësia dhe peshkimi” neni 38 (ish-neni 32 TKE), neni 39 (ish-neni 33 TKE), neni 42 (ish-neni 36 TKE), neni 43 (ish-neni 37 TKE).*
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Kapitulli II “Bujqësia dhe peshkimi”, **neni 24 “Përkufizim”, neni 26 (shfuqizimi i kufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njejtë me to për importet e produkteve bujqësore, përfshirë ato të peshkimit në tregtinë mes Shqipërisë dhe BE-së), neni 28 “Produktet e peshkimit”, Titulli VIII “Politikat e bashkëpunimit”, neni 96 “Peshkimi” dhe Shtojca III e MSA-së “Tarifat konçensionare të BE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar”.**

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 104/2000”, e ndryshuar”.
- Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi Fondin Europian Detar dhe të Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr.2328/2003, (KE) Nr.861/2006, (KE) Nr.1198/2006 dhe (KE) Nr.791/2007 dhe Rregulloren (BE) Nr.1255/2011 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit”.

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

3. SHQYRTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË DISPOZITAVE TË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS TË BE

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa ndryshime si vijon:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) Nr. 1379/2013 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 104/2000”, e ndryshuar. Numri CELEX 32013R1379, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.354, datë 28.12.2013, fq.1-21.
- Rregulloren (BE) Nr. 508/2014 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi Fondin European Detar dhe të Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr.2328/2003, (KE) Nr.861/2006, (KE) Nr.1198/2006 dhe (KE) Nr.791/2007 dhe Rregulloren (BE) Nr.1255/2011 të Parlamentit European dhe të Këshillit”. Numri CELEX 32014R0508, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.149, datë 20.05.2014, fq.1-66.”

2. Në nenin 9 të projektligjit i cili parashikon që në ligjin në fuqi për peshkimin të shtohen nenet 61/1 dhe 61/2, pika 1 (b) e nenit 61/1 të riformulohet si vijon:

“1.Organizatat prodhuese, në sektorin e peshkimit, ndjekin këto objektiva:

- a)
- b) Parandalojnë dhe zvogëlojnë sa më shumë që të jetë e mundur zëniet jo objekt peshkimi të popullatave tregtare dhe kur është e nevojshme, të bëjnë përdorimin më të mirë, pa krijuar treg për zëniet që janë nën dimensionet minimale, të përcaktuara për mbrojtje, sipas akteve nënligjore;”

Shkronja (b), e pikës 1 të nenit 7 “Objektivat e organizatave të prodhuesve” të Rregjullores (BE) Nr. 1379/2013 që përafrohet nga neni 9, pika 1(b) i projektligjit të propozuar, parashikon sa vijon:

“(b) avoiding and reducing as far as possible unwanted catches of commercial stocks ...”.

3. Në nenin 9 të projektligjit i cili parashikon që në ligjin në fuqi për peshkimin të shtohen nenet 61/1 dhe 61/2, pika 3 e nenit 61/1 të riformulohet si vijon:

“3. Organizatat prodhuese mund të ndjekin objektiva të tjerë plotësues”.

4. KORRIGJIMI I TABELAVE TË PËRPUTHSHMËRISË QË SHOQËROJNË PROJEKTLIGJIN

Tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjin duhet të korrigjohen nga institucioni propozues, sepse nuk janë plotësuar sipas kritereve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së (Neni 17, pika 2 dhe 3 të ligjit Nr.15/2015). Nga shqyrtimi dhe krahasimi i tabelave të përputhshmërisë me tekstin e projektligjit është konstatuar se teksti i neneve të projektligjit nuk korrespondon me tekstin e neneve përkatëse të projektligjit të shënuara në tabelën e përputhshmërisë.

Bazuar në nenin 17, pikat 3 dhe 5 të ligjit 15/2015 *“Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”*, sugjerojmë që KIE t’i kërkojë institucionit propozues të projektligjit:

- korrigjimin e tabelave të përputhshmërisë, duke dhënë tekstin e saktë të neneve të projektligjit, që i korrespondon neneve përkatëse në tekstin e projektligjit, dhe ridërgimin e tyre në Kuvend,
- reflektimin në tabelat finale të përputhshmërisë të ndryshimeve që do të pësojë projektligji gjatë shqyrtimit dhe miratimit të tij në Kuvend.

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit e miratoi atë shumicë votash.

**KRYETAR
GENC POLLO**